



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

**Prishtinë, maj 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Fejzullah Fejza (udhëheqës i ekipit) dhe Neslihane Mati dhe Krenare Pirana (anëtare të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Florim Beqiri.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	9
4 Qeverisja e mirë.....	21
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	31
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	33

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare Vjetore për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 30.10.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Shëndetësisë.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### **Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes**

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

#### **Theksim i çështjes**

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se:

Pasuria kapitale me vlerë mbi 1,000€ nuk prezanton vlerën e saktë për arsyen se 876,216€ të fondeve për investimet në vijim, nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurisë, dhe rrjedhimisht as në PFV.

Po ashtu, edhe pasuria jo kapitale nën 1,000€, nuk prezanton vlerën e saktë të pasurive për arsyen se vlera prej 214,710€ nuk ishin regjistruar në modulën e-pasuria.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore****Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018**

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ministrisë gjatë procesit të auditimit.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë së Shëndetësisë nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### Theksimi i çështjes

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se:

Neni 19.3.1- Pasuria kapitale me vlerë mbi 1,000€ nuk prezanton vlerën e sakta të pasurive. Auditimi i kryer ka rezultuar me faktin se pasuritë me vlerën 876,216€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurisë, dhe rrjedhimisht edhe PFV-të ishin nën deklaruar për të njëjtën vlerë.

Edhe te neni 19.3.2 pasuritë jo kapitale nën 1,000€, shpenzimet/blerjet e vitit 2018 në vlerë prej 214,710€ për këtë klasë të pasurive nuk ishin regjistruar në modulën e-pasuria.

Mosregjistrimi i pasurive kapitale kishte ndodhur për shkak se pagesat për këto pasuri ishin bërë në fund vit 2018 me ç'rast zyrtari i pasurisë nuk kishte arritur t'i regjistroj brenda periudhës raportuese. Sa i takon modulit e-pasuria, shkak i nen deklarimit ishte se zyrtari i pasurisë në MSh nuk kishte qasje për regjistrim të pasurive nën 1,000€ në të dhe rrjedhimisht nuk ka regjistruar asnjë nga këto transaksione.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV**

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri i Shëndetësisë është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Shëndetësisë.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigorisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.



---

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Ministria e Shëndetësisë (MSh) kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013/MF-shpenzimi i parave publike, si dhe Rregulloren MF nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Përveç gabimeve të cilat kanë ndikuar në theksim të çështjes, PFV përmbajnë edhe gabimin si:

- Te neni 16 - Raporti i të arkëtueshmëve i prezantuar prej 318,914€ ishte nën deklaruar për 80,287€, pasiqë për këtë shumë nuk janë përfshirë në saldot e llogarive të arkëtueshme. Kjo kishte ndodhur për shkak se njësitë vartëse të MSh-së nuk kishin raportuar gjendjen reale të këtyre llogarive.

Të gjeturat më lartë, tregojnë që përgatitja e PFV-ve është menaxhuar relativisht mirë, por me disa dobësi të cilat kërkojnë vëmendje më të lartë nga MSh-ja në të ardhmen.

### DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e plotë me disa pasaktësi në shpalosje të tyre.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

**Rekomandimi A1** Ministri duhet të siguroj se do të bëhet regjistrimi i të gjitha pasurive kapitale dhe jo kapitale si dhe raportimin e të gjitha llogarive të arkëtueshme.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në

---

mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

## Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në përgjithësi sistemet kyçe të shpenzimeve, sidomos shpenzimet për barnat e listës esenciale kanë shënuar një progres mjaft të dukshëm krahasuar me periudhat e mëhershme. MSh në këtë segment ka treguar një rol shumë proaktiv duke e menaxhuar procesin në mënyrë shumë efektive duke vendosur një standard të ri i cili ka marrë në konsideratë çmimet e tregut gjatë procesit të kontraktimit të barnave. Për çdo kontratë të furnizimit me barna të listës esenciale, kishte caktuar menaxher të kontratës. Po ashtu, një rol dinamik kishte treguar në respektimin e sasive të furnizimit duke mos tejkaluar sasi të kontraktuara përmes kontratave kornizë. Njëkohësisht kontraktimi i barnave të listës esenciale gjatë 2018 ishte bërë duke u bazuar në hulumtimin e çmimeve të tregut, duke mos lejuar shpërputhje çmimesh mes kontraktimit të barnave të listës esenciale dhe çmimit të tregut në Kosovë. Një rol aktiv gjatë 2018, MSh kishte luajtur edhe në adresimin e vlerës së lartë të avanceve të hapura, duke e përcjellë rastin në organet kompetente të hetuesisë dhe duke ofruar bashkëpunim të ngushtë lidhur me këtë çështje. Edhe çështjet e trajtuara tek projektet kapitale në vazhdim, MSh kishte krijuar komision për evidentimin e gjendjes faktike në terren dhe kishte marrë masa të nevojshme për korrigjimet e tyre në pajtim me kushtet e kontratës.

Përkundër këtij progresi, ende në disa fusha të menaxhimit kërkohen përmirësime si: performanca e shpenzimeve për projekte kapitale, fusha e subvencioneve dhe transfereve, respektivisht programi për trajtim mjekësor jashtë institucioneve publike shëndetësore, menaxhimi i pasurive dhe llogarive të arkëtueshme.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>65,526,649</b>	<b>63,820,661</b>	<b>58,559,449</b>	<b>57,567,776</b>	<b>49,774,144</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	64,426,649	61,523,770	57,163,507	57,025,126	45,671,695
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup>	-	-	-	-	59,151
Të hyrat vetjake	-	-	-	-	529
Donacionet e jashtme		1,196,891	443,876	99,609	319,425
Huamarrja	1,100,000	1,100,000	952,066	443,041	3,723,344

Në vitin 2018, ministria ka shpenzuar mbi 92% të buxhetit final ose 58,559,449€. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>65,526,649</b>	<b>63,820,661</b>	<b>58,559,448</b>	<b>57,567,776</b>	<b>49,774,144</b>
Pagat dhe Mëditjet	7,653,409	8,065,991	8,050,649	8,313,972	7,940,750
Mallrat dhe Shërbimet	35,360,887	38,409,087	34,337,304	29,506,459	24,661,109
Shërbimet komunale	230,548	181,489	155,407	183,802	183,845
Subvencionet dhe Transferet	7,913,805	11,366,540	11,016,744	14,350,049	9,841,960
Investimet Kapitale	14,368,000	5,797,554	4,999,344	5,213,494	7,146,480

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, përfshirë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me atë fillestar ishte rritur për 412,582€ apo në masën prej 5.4%. Kjo ka ndodhur për arsye të mbulimit të shpenzimeve për punonjësit e ri apo të transferuar;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 3,048,200€ apo 8.6% me vendime të Qeverisë për furnizim me barna;
- Kategoria e shpenzimeve komunale është zvogëluar në masë të lehtë për 49,059€ apo 21.3% si pasojë e dinamikës më të ulët të shpenzimit karshi buxhetimit;

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual

- Rritje në buxhetin final karshi atij fillestar kishte kategoria subvencione dhe transfere për 3,452,735€ apo 43.6%;
- Buxheti final për investime kapitale është zvogëluar për 8,570,446€ apo 59.6%. Kjo përshtatje kishte ndodhur pasi që ministria nuk kishte arritur t'i realizoj disa projekte të mëdha kapitale.
- Përshtatjet buxhetore nëpër kategori ishin bërë me vendime të qeverisë si: Vendimet nr. 04/74 i datës 06.11.2018, nr. 08/76 i datës 21.11.2018, nr.11/79 i datës 11.12.2018 dhe nr. 07/80 i datës 18.12.2018, kursime, ndarje dhe transfere buxhetore ndërmjet kategorive.

### Çështja B1<sup>3</sup> – Fondet për mallra dhe shërbime dhe investime kapitale nuk janë shpenzuar sipas planifikimit

**Gjetja** Edhe përkundër këtyre përshtatjeve (lëvizjeve buxhetore) mallra dhe shërbime dhe investime kapitale, ministra nuk kishte arritur ta shpenzoj buxhetin sipas planit të rrjedhës së parasë. Mallrat dhe shërbimet ishin shpenzuar 89% përderisa investimet kapitale 86%. Për më tepër, në tremujorin e fundit kishte një fluks të madh shpenzimesh për investime kapitale (57%), të cilat mund t'i nënshtrohen rrezikut të kontrolleve të pamjaftueshme për shkak të numrit të madh të pagesave.

Shpenzimi kaq i ultë tek mallrat dhe shërbimet ishte për shkak të lidhjes së kontratave për furnizim me barna në dhjetor 2018, përderisa shpenzimi i ultë tek investimet kapitale ishte për shkak të mosrealizimit të projekteve kapitale.

**Rreziku** Mos iniciimi i aktiviteteve me kohë, kontrollet e dobëta në kontraktim, mbikëqyrje dhe realizim mund të ndikojnë që objektivat e parashikuara të ministrisë të mos realizohen.

**Rekomandimi B1** Ministri duhet të përcaktoj një dinamikë më të përshtatshme të aktiviteteve, të përmirësoj kontrollet në fushën e kontraktimeve, mbikëqyrjes dhe realizimit të projekteve për tu siguruar se ato realizohen sipas planit të parashikuar.

#### 3.1.1 Të hyrat

Bazuar në aktivitetin vjetor për 2018, MSh kishte mbledhur të hyra në vlerë prej 4,717,275€. Ministria e Shëndetësisë nuk kishte arritur ende të bëjë planifikim për të hyra të cilat mund t'i realizoj gjatë vitit, prandaj inkasimi i tyre ishte bërë pa ndonjë planifikim paraprak.

<sup>3</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Edhe pse Ministria nuk ka marrëveshje për shfrytëzimin e të hyrave të realizuara, ajo do të duhej të kishte planifikuar realizimin e të hyrave i cili do të shërbente si pikë referuese për përcjelljen e dinamikës së realizimit të tyre. Të hyrat realizohen nga programe të ndryshme dhe lidhen me shërbimet të cilat ofrohen, siç janë: licencimi, shitja e shërbimeve, gjobat nga inspektorati farmaceutik dhe shëndetësor, etj.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	0	0	4,717,275	4,614,915	4,923,661
<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>4,717,275</b>	<b>4,614,915</b>	<b>4,923,661</b>

### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Kategoria e Pagave dhe shtesave, administrohet nga sektori i burimeve njerëzore të MSh-së, ndërsa paguhen përmes sistemit të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF.

Buxheti final i kësaj kategorie ishte 8,065,991€ i cili krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 412,582€. Kjo shumë ishte shpenzuar pothuajse në tërësi - 8,050,649€ apo 99,8%. Numri i lejuar i stafit me ligj të buxhetit ishte 1,158 ndërsa aktuali ishte 981.

Rezultatet e testimit tonë kanë rezultuar me:

---

## Çështja A2 – Pagesa e zyrtarëve të komunitetit serb pa evidenca të vijueshmërisë së tyre në punë

**Gjetja** Duke u bazuar në marrëveshjen e Brukselit, përkatësisht në Ligjin nr.04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Qeveria e Kosovës me vendim nr. 06/39 të datës 22.07.2015, ka aprovuar konkluzionet e dakorduara për Shpërbërjen e të ashtuquajturës “Mbrojta Civile” e cila ka funksionuar në komunat veriore të Kosovës, si dhe mbështet zotimet e përcaktuara me këto konkluzione. Përmes këtij vendimi, obligohen ministritë dhe agjencitë përkatëse që të bëjnë zbatimin e konkluzioneve sipas përgjegjësisë ligjore.

Këta punonjës ishin planifikuar të sistemohen nëpër komunat në pjesën veriore të Kosovës.

Në MSh pas një procesi të rekrutimit me akt emërimi ishin integruar 22 nëpunës të komunitetit serb ish pjesëtarë të “Mbrojtjes Civile”..

Zyrtarët e lartcekur në vitin 2018, nuk ishin paraqitur në vendin e punës në Spitalin e Mitrovicës ku ishin përcaktuar me aktemërimë, siç i obligon Ligji i punës Nr. 03/L-212 dhe kontrata e punës, përderisa ministria i kishte bërë pagesën e pagave të tyre në shumë të plotë. Vlera e paguar për shpenzimet e pagave për vitin 2018, për 22 zyrtarë ishte 97,733€.

Kjo ka ndodhur për shkak se nuk ka kontrole menaxheriale për të siguruar se të gjithë nëpunësit publik do të jenë të pranishëm në vendin e punës gjatë orarit të punës.

**Rreziku** Pagesa e punonjësve në mungesë të dëshmimeve të vijueshmërisë në punë dëmton buxhetin e MSh-së, dhe rrit rrezikun e pagesave të parregullta.

**Rekomandimi A2** Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve duke bërë monitorimin e vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Nëse problemi nuk mund të zgjidhet brenda ministrisë, kjo duhet të diskutohet në nivel të Qeverisë dhe të nxirren vendimet e duhura.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe komunalit ishte 38,590,576€, ndërsa shpenzimi është 34,492,711€. Pjesëmarrjen më të madhe në këto shpenzime e bëjnë furnizimi me barna të Listës Esenciale me 87% apo 30,105,847€, gjersa pjesa tjetër i dedikohet shpenzimeve tjera operationale. Dy mostra të përzgjedhur nga popullacioni i mallrave dhe shërbimeve në vlerë 315,180€ (279,544€

---

dhe 35,636€), nuk janë audituar nga ne për shkak se ishin në procedurë hetimore nga organet kompetente.

Nga shuma e shpenzuar për barna të Listës esenciale prej 30,105,847€, për qëllime të testimeve substanciale janë analizuar 85 njësi mostre në vlerë totale prej 16,363,689€ dhe për qëllime të pajtueshmërisë 23 mostra me një vlerë totale prej 5,871,890€. Për furnizimet e barnave jashtë Listës esenciale, janë testuar 8 mostra me vlerë totale prej 74,209€.

Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, jashtë listës së barnave, janë ekzaminuar 7 mostra me vlerë prej 55,198€. Nga të gjitha mostrat e ekzaminuara më sipër, nuk kemi gjetur ndonjë parregullsi apo pa pajtueshmëri ligjore, përveç dy rasteve si më poshtë:

---

**Çështja A3 - Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut (QKTGj) nuk kishte formuar zyrtarisht komisionet e pranimit të pasurisë jo financiare**

**Gjetja** Sipas Rregullores nr. 01/2013 për shpenzimin e parave publike, respektivisht neni 23 paragrafi 1, citon se “pranimi i mallit/shërbimit bëhet nga zyrtari/komisioni i autorizuar”. Po ashtu, neni 8 i rregullores nr.02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat Buxhetore parasheh që “Zyrtari Kryesor Administrativ me vendim formon komisionin për pranimin e pasurisë jo financiare”.

Qendra Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut ka bërë pagesë me vlerën 64,425€ për “Furnizim me Teste Serologjike”. Pranimi i testeve ishte bërë nga komisioni i pranimit të mallit i përbërë nga tre persona për formimin e të cilit nuk kishte ndonjë vendim (autorizim). Ne kemi vërejtur se ky komision nuk ishte caktuar nga Drejtori Ekzekutiv i QKTGj siç kërkohet me legjislacionin e lartshënuar, i cili e parasheh se autoriteti i vetëm për caktimin e komisioneve është Zyrtari Kryesor Administrativ.

Drejtori Ekzekutiv i QKTGJ-së nuk kishte formuar zyrtarisht komisionin për pranimin e pasurisë jo financiare, sepse nuk kishte njohuri për kërkesat që burojnë nga Rregulla financiare Nr. 01/2013.

**Rreziku** Mos ndjekja e rregullores përkatëse të pasurisë jo financiare, duke përfshirë mungesën e vendimeve zyrtare për caktimin e anëtarëve të komisionit të pranimit të pasurisë jo financiare, mund të ndikoj në pranim të pasurisë jo financiare joadekuate që nuk përputhet me specifikacionin e kontratës.

**Rekomandimi A3** Ministri duhet të siguroj se Drejtori Ekzekutiv i QKTGJ-së zbaton me konsistencë kërkesat e rregulloreve dhe formon me kohë komisionet për pranimin e mallrave dhe pasurive të blera jo financiare.

## Çështja A4 - Mungesë e raporteve nga menaxherët e kontratave

**Gjetja** Në Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik pika 61.20 k ceket se "njëra ndër përgjegjësitë e menaxherit të projektit është dorëzimi i raporteve mbi progresin e projektit ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA".

Qendra Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut (QKTGj) ka bërë pagesë me vlerën 64,425€ për "Furnizim me Teste Serologjike". QKTGj kishte caktuar menaxherin e kontratës për përcjelljen e procesit të mbarëvajtjes së furnizimit dhe pagesës, por ne nuk kemi hasur raport nga menaxheri i kontratës për progresin e furnizimeve sipas specifikave të kontratës.

Menaxheri i kontratës nuk ishte në dijeni për nevojën e përgatitjes së ndonjë raporti, dhe nuk kishte përgatit raport lidhur me progresin dhe zbatimin e kësaj kontrate.

**Rreziku** Mungesa e raporteve nga menaxherët e kontratave për realizimin e tyre, zvogëlon sigurinë që kontratat janë realizuar konform specifikave të parapara

**Rekomandimi A4** Ministri duhet të siguroj se Drejtori Ekzekutiv i QKTGJ-së do të përmbushë kërkesën ligjore që të gjithë menaxherët e kontratave pas përfundimit të kontratave të përgatisin raporte të hollësishme konform rregulloreve të prokurimit.

### 3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Me ligjin 06/L-020 për buxhetin 2018, MSH për kategorinë Subvencione dhe Transfere kishte buxhetuar 7,913,805€. Me vendim të Qeverisë në fund vit buxheti i kësaj linje ishte rritur për 3,452,735€, dhe shuma e buxhetit final kishte arritur në 11,366,540€. Shpenzimi për vitin 2018 ishte 11,016,744€ ose shprehur në përqindje 97%.

Shpenzimet kanë të bëjnë me Trajtimin Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJISHP), subvencionimin e specialistëve - Aftësimi specialistik, si dhe subvencionimin e shoqatave/profesionistëve shëndetësor për Edukim të Vazhdueshëm Mjekësor (EVM).

Në këtë fushë janë identifikuar disa mangësi si rezultat i kontrolleve të dobëta.



---

**Çështja B2 - Ministria nuk është duke bërë harmonizim me Spitalet në të cilat kryhen shërbimet për TMJIPSH**

**Gjetja** Paragrafi 5 i nenit 12 të Udhëzimit Administrativ UA nr.03/2017 për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJISHP) obligon që divizioni për TMJISHP të mbajë komunikim të rregullt me institucionet ku trajtohen pacientët të cilët i subvencionon MSh, dhe në baza 3 mujore, të siguroj informacion për statusin e trajtimit të tyre.

Përkundër themelimit të komisionit për barazime në vitin 2017, i cili kishte bërë barazime me tre spitale dhe kishte konstatuar mjete të pashfrytëzuara në vlerë 111,015€<sup>4</sup>, në vitin 2018 MSh kishte shuar këtë komision për arsye konflikti të interesit tek anëtarët e atij komisioni.

Si rezultat i kësaj MSh në vitin 2018 nuk ka themeluar ndonjë komision për barazime me Spitalet. Janë 274 spitale private brenda dhe jashtë Kosovës me të cilat MSh nuk ka kryer asnjëherë barazim për subvencionimin e pacientëve me kostot efektive të trajtimeve.

Ky mosbarazim po ndodh për shkak se ministria ende nuk ka krijuar ndonjë mekanizëm (komision) për këtë çështje si dhe nuk ka hartuar procedura të qarta për të rregulluar procesin e harmonizimeve me spitale private.

**Rreziku** Mungesa e një procesi efektiv të harmonizimit rezulton që MSh të mos rimbursohet nga spitale private në rastet kur shpenzimet janë më të ulta se sa fondet e dhëna nga ministria për pacientët e trajtuar.

**Rekomandimi B2** Ministri duhet menjëherë të krijojë një komision për të zbatuar një proces të harmonizimit që do të mbuloj të gjitha spitale private, dhe se çdo fond që u paguhet këtyre spitaleve dhe që tejkalon shpenzimet aktuale të trajtimit, duhet të kthehet në MSh.

---

<sup>4</sup> Këto mjete të konstatuara si të pashfrytëzuara nuk ishin kthyer në buxhetin e ministrisë as në 2018.

### Çështja B3 - Mos arsyetim i mjeteve për trajtimet mjekësore të subvencionuara

**Gjetja** Bazuar në vendimin e Drejtorit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore (FSSH), dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ 03/2017 për TMJISHP, pacientët përfitues të programit për TMJISHP me rastin e përfundimit të trajtimit, duhet të dorëzojnë në ministri faturat e trajtimit.

Nga tetëdhjetë e një (81) mostrat e testuara për TMJIPSH, që përfaqësojnë 9% të gjithë pacientëve të subvencionuar nga programi TMJISHP, ne kemi vërejtur se vetëm 22 pacientë apo 27% e përfituesve kishin sjellë faturat e trajtimeve në FSSH. Po ashtu, nga 22 mostrat kur pacientët kanë kthyer faturat e trajtimit, në tri (3) mostra kemi vërejtur që ka mos përputhje në mes të pro faturave dhe faturave të paguara në vlerë prej 7,336€.

Kjo ndodh për shkak të neglizhencës nga palët përfituese për t'i ofruar dëshmitë pas trajtimit për shpenzimet e ndodhura.

**Rreziku** Mos ofrimi i dëshmive për kostot e trajtimit nga palët, rrit rrezikun që mjetet e dhëna nuk përdoren për qëllimin e paraparë.

**Rekomandimi B3** Ministri duhet të krijoj mekanizma efektiv për të siguruar se palët përfituese janë duke e respektuar obligimet për arsyeshmërinë e plotë të shpenzimeve të subvencionuara nga ministria.

#### 3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti fillestar për investime kapitale ishte 14,368,000€, gjersa me buxhetin final ishin të ndara 5,797,554€. Prej tyre ishin shpenzuar gjithsej 4,999,344€. Kjo lë të kuptohet se projeksionet buxhetore ishin bërë pa analiza të mirëfillta, dhe si rezultat i kësaj, korrigjimet gjatë vitit ishin të shumta.

Nga 42 mostra të testuara substantive dhe 10 mostra për pajtueshmëri nga kategoria e investimeve kapitale, pos çështjeve të cilat i kemi trajtuar tek pjesa e realizimit të buxhetit, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Kjo kërkon procedura të kontrollit dhe menaxhimit të cilat vërtetojnë ekzistencën e pasurive dhe sigurojnë të dhëna të sakta dhe të azhurnuara për pasuritë e organizatës. Vlera e

---

pasurive mbi 1,000€ e prezantuar në PFV ishte 6,001,635€, ndërsa nën 1,000€ ishte 562,442€. Problemet që ndërlidhen me pasuri i kemi trajtuar tek kapitulli opinioni i auditimit.

### 3.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Sipas shënimeve të thesarit dhe prezantimit në PFV, gjendja e avanceve për udhëtime zyrtare të hapura në MSh për 2018 është 721,085€. Nga to si gjendje e bartur nga 2017 janë 522,287€. Pjesa e avanceve të vitit 2018 në shumën prej 198,798€ përbëhet nga: 136,152€, janë korrigjime të bëra nga thesari të avanceve të ShSKUK-së, d.m.th. fshirja nga kjo llogari dhe ngarkimi i llogarisë së MSh-së; dhe pjesa tjetër prej 62,646€, janë avance të hapura të tremujorit të parë të viti 2018.

Meqenëse problematika e avanceve të hapura është në procedura hetimore nga ana e organeve kompetente, ne nuk e kemi trajtuar këtë kategori.

### 3.4 Të arkëtueshmet

Ministria e Shëndetësisë për vitin 2018, kishte prezantuar në PFV, llogari të arkëtueshme në vlerë prej 318,914€ që në krahasim me vitin 2017 kanë shënuar rënie për shumën prej 152,487€. Trendi i zvogëlimit të llogarive të arkëtueshme është si rezultat i përmirësimit të kontrolleve në këtë fushë nga Ministria e Shëndetësisë. Megjithatë këto kontrolle duhet edhe më tej të fuqizohen për të rritur dhe përmirësuar performancën e Ministrisë në efikasitetin e mbledhjes së borxheve nga debitorët.

Gabimet e hasura në deklarinimin e llogarive të arkëtueshme janë trajtuar tek PFV.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.5 Obligimet e papaguara

Obligimet e papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 7,989,264€, përderisa në PFV e vitit 2017 kishte deklaruar 4,266,793€. Kjo tregon një rritje e obligimeve të papaguara prej 47% në vitin 2018. Pjesa më e madhe e obligimeve i takon Trajtimit të Shëndetësorë Jashtë Vendi me 90%. Struktura e obligimeve të vitit 2018, sipas kategorive është, mallra dhe shërbime si dhe komunal 146,559€, subvencione dhe transfere 7,220,178€ dhe shpenzime kapitale 622,527€.

Në këtë fushë janë identifikuar disa dobësi si rezultat i mos efektivitetit të kontrolleve.

---

**Çështja A5 - Faturat e pranuar jashtë protokollit**

**Gjetja** Në paragrafin 1.3, neni 24 i Rregullës Financiare 01/2013, Shpenzimi i parave publike, kërkohet që fatura e cila pranohet duhet të protokollohet dhe të evidentohet në librin e faturave.

Nga gjithsej 14 fatura të testuara nga mallrat dhe shërbimet dhe investimet kapitale, dy fatura të operatorëve ekonomik nuk ishin regjistruar në libër të protokollit në momentin e pranimin të faturës nga Operatori Ekonomik.

Këto dy fatura janë “Mirëmbajtje e ventilimit” me vlerë 6,726€ në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, dhe “Infrastrukturë Spitalore” me vlerë 8,400€ në Institutin Kombëtar për Shëndetësinë Publike.

Arsye e kësaj ishte se disa fatura janë përcjellë direkt në Departamentin e Prokurimit nga Operatorët Ekonomik, dhe zyrtari i përgjegjës për pranimin e faturave nuk kishte njohuri mbi pranimin e tyre. Këtu shpërfaq një bashkëpunim të dobët në mes të Departamentit të prokurimit dhe zyrtarit përgjegjës që mban evidencat në librin e protokollit.

**Rreziku** Mos zbatimi i procedurave të duhura të kontrollit të brendshëm si dhe mosbashkëpunimi mes zyrtarëve gjatë pranimin të faturave, rrisin rrezikun që faturat të mos evidentohen nga njësitë e MSh dhe rrjedhimisht edhe të mos paguhen me kohë.

**Rekomandimi A5** Ministri duhet të siguroj se njësitë e MSh-së faturat i evidentojnë dhe pranojnë përmes protokollit dhe se të njëjta regjistrohen dhe procedohen me kohë për pagesë.

## Çështja B4- Aprovim i kërkesave pa fonde buxhetore në programin TMJIPSH

**Gjetja** Sipas Rregullës Financiare 01/2013, neni 12 paragrafi 3 përcakton se organizata buxhetore nuk ndërmerr asnjë obligim gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara.

Ministria kishte hyrë në obligime financiare më shumë se sa ndarjet buxhetore të kategoria subvencione dhe transfere. Buxheti i ndarë për këtë kategori në vitin 2018 ishte 11,366,540€, shpenzimi 11,016,744€, përderisa 7,220,178€, janë obligime të raportuara në PFV në kategorinë subvencione dhe transfere, që duhet të paguhen në vitin 2019.

Shkaku i kësaj rritje të obligimeve është rezultati i aprovimit të kërkesave për trajtim mjekësor të pacientëve jashtë institucioneve publike shëndetësore nga bordi ekzekutiv i këtij institucioni, pa marrë në konsideratë ndarjet e dedikuara buxhetore.

**Rreziku** Shumat e raportuara të obligimeve të pa paguara janë shuma domethënëse për buxhetin e ministrisë, dhe si të tilla, mund të ndikojnë në balancat buxhetore për vitin e ardhshëm.

**Rekomandimi B4** Ministri të siguroj se Bordi ekzekutiv i TMJIPSH me rastin e aprovimit të kërkesave për trajtim të pacientëve, duhet të merr në konsiderim fondet buxhetore në dispozicion dhe të mos aprovoj kërkesa që krijojnë obligime për vitet vijuese.

## 4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontroleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike. Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave. Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

## Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ministria e Shëndetësisë gjatë vitit 2018 kishte treguar një rol shumë prokativ në shumë fusha të menaxhimit dhe llogaridhënës. Në fushat kryesore të shpenzimeve siç janë shpenzimi për barnat e listës esenciale respektivisht kontraktimi i tyre roli i ministrisë ka qenë shumë prezent duke marrë

në konsideratë që çmimet e tyre të jenë sipas çmimeve të tregut dhe jo të jenë shumë herë më të larta. Edhe në kategorinë e investimeve kapitale MSh kishte treguar një rol proaktiv duke i trajtuar me kujdes të shtuar projektet e rëndësishme kombëtare, siç është rasti i funksionalizimit të pajisjes Angiografi. Po ashtu, tek çështjet specifike të dala nga raporti i auditimit për 2017, siç ishte rasti me pagesën e dyfishtë të qendrës së dializës në Mitrovicë, çështjen e avanceve dhe çështjen e adaptimit të hapësirave për angiografi ministri e kishte adresuar edhe tek organet përgjegjëse për hetim. Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga MSh përgjatë vitit 2018 është përmirësuar dukshëm. MSh ka treguar një dinamikë proaktive në zbatimin e rekomandimeve të dala nga raportet e auditimit të ZKA-së. Komiteti i auditimit në përgjithësi ka luajtur një rol më të shprehur dhe proaktiv për të adresuar gjetjet e auditimit tek menaxhmenti.

Megjithëse ende në disa programe të MSh janë vërejtur disa dobësi në qeverisje, si rast kemi mos nxjerrja e vendimit për caktimin e komisioneve të pranimit të mallrave, mungesa e pranimit të faturave përmes protokollit në AKPPM dhe IKSHP, mos përfshirja e të gjitha llogarive të arkëtueshme në regjistra nga Inspektoratet dhe QKTGJ.

## 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit- Drejtori dhe dy auditorë. Në shtator 2018 është rekrutuar edhe një auditor i ri në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore (FSSH), dhe është funksionalizuar NJAB në FSSH. Statusi i NjAB, Kodi i Etikës, Plani Strategjik 2019-2021, dhe Plani Vjetor 2019 në FSSH është aprovuar në muajin Dhejtor 2018.

NjAB për vitin 2018 kishte planifikuar t'i kryejë gjithsej 13 auditime, nga të cilat 8 janë më prioritet të lartë, dhe 5 me prioritet të mesëm. Nga plani i vjetor i punës ka arritur të kryejë 8 auditime, ndërsa sipas kërkesës së menaxhmentit ka kryer 5 auditime.

Fushëveprimi i auditimeve të vitit aktual, është si vijon: (a) Të hyrat për vitin 2017/18, (b) Shpenzimet në MSh, (c) Procedurat e rekrutimi për vitin 2017-2018 në MSh, (d) Planifikimi dhe menaxhimi i aktiviteteve të prokurimit sipas dinamikës së paraparë për vitin 2017 në IKSHPK, (e) Planifikimi dhe menaxhimi i aktiviteteve të prokurimit sipas dinamikës së paraparë për vitin 2017 në AKPPM, (f) Menaxhimi i kontratave në DShB, (g) Avanset me kërkesë, (gj) Adaptimi i hapësirave për angiografi- me kërkesë, (h) Rishikimi i shpërndarjes së insulinave, (i) Rishikimi i aspektit ligjor të borxheve të mbetura, (j) Menaxhimi i barnave në DSHF, (k) Pagesat e kujdestarive për specializantët e rregullt dhe vullnetar për vitin 2018, (l) Menaxhimi i kontratave për barna në DF-2018.

Auditimet e brendshme kanë përfshirë fusha me rëndësi për veprimtarinë dhe objektivat e organizatës. NJAB ka dokumentuar dhe analizuar problemet dhe ka propozuar zgjidhje për menaxhmentin. NJAB kishte hartuar Planin strategjik për periudhën 2018-2020 ku kishte identifikuar rreziqet e veprimtarisë. Po ashtu, bazuar në planin strategjik NJAB kishte përpiluar edhe planin vjetor i cili ishte miratuar nga Ministri dhe Komiteti i Auditimit.

---

Komiteti i Auditimit (KA) përbëhet nga 5 anëtar. KA kishte mbajtur gjithsej 5 takime gjatë vitit 2018, të cilat janë dokumentuar me procesverbale, i njeti ka përcjellë tek ministri të gjitha rekomandimet e NjAB për zbatim. Menaxhmenti ka qenë proaktiv në trajtimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB dhe me kohë ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për zbatimin e tyre.

### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## **4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut**

Për një planifikim të mirë, për mbikëqyrje të aktiviteteve në baza të rregullta dhe për vendimmarrje efektive, menaxhmenti i MSh-së ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet e masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguuar ndaj rreziqeve që kërcënojnë ministrinë.

Ministria e Shëndetësisë përgjatë 2018 ka pasur 4 njësi vartëse (Fondin e Sigurimeve Shëndetësore-FSSH, Agjencioni Kosovar për Produkte dhe Pajisje Medicinale-AKPPM, Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut-QKTGJ si dhe Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës-IKSHPK. Në nivele të raportimit menaxherial këto njësi raportojnë tek ministri i MSh, gjersa në aspektin operacional raportojnë tek Zyrtarët Kryesor Administrativ të njësisë. Në aspektin e raportimit financiar, raportet e këtyre njësisë konsolidohen në nivelin më të lartë hierarkik, pra në MSh. Cilësia e raportimit të tyre në ministri është përmirësuar ndjeshëm, mirëpo ende ka nevojë për përmirësime sidomos në fushën menaxhimit më pasuritë, llogari të arkëtueshme dhe obligime.

Menaxhmenti i ministrisë përgjatë vitit ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet. Ne kemi konfirmuar se masat e aplikuara janë në përmirësim e sipër dhe gradualisht janë duke u orientuar kah përgjigja efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Krahasuar me vitet paraprake, MSh ka treguar një rol shumë aktiv në parandalimin e dobësive të përcjella vit pas vit si në nivelin e raportimit menaxherial, ashtu edhe në fushën operationale duke bërë që fushat e ndjeshme të shpenzimeve, sidomos shpenzimet për barna të listës esenciale të jenë të njëjta siç janë në tregun e lirë dhe mos të krijohen monopole. Një veprim shumë të dobishëm MSh kishte demonstruar edhe në funksionalizimin e aparaturës së Angiografit, i cili i ka rritur shërbimet e kryera në sektorin publik në Kosovë dhe ka bërë që të parandalohen trajtimet e ndryshme për sëmundjet kardiake jashtë institucioneve publike në Kosovë.

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të MSh-së kishte rezultuar me 27 rekomandime. MSh kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Vlen të theksohet se ministria kishte trajtuar me seriozitet raportin e auditimit të vitit 2017, më ç'rast kishte themeluar një komision për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve. Ky komision kishte përcjellë me vëmendje zbatimin e rekomandimeve dhe kishte raportuar te menaxhmenti për progresin e arritur në baza mujore.

Raporti i auditimit për vitin 2017 ishte trajtuar në mbledhjen e datës 19.12.2018 nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Financave Publike dhe rekomandimet e dala nga ai takim ishin dakorduar t'i adresohen ministrit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, prej 27 rekomandimeve, (15) rekomandime janë zbatuar apo 56%, tri (3) ishin në proces të zbatimit apo 11% e tyre, shtatë (7) kanë mbetur të pazbatuara apo 26% dhe dy (2) rekomandime të pazbatuara të mbyllura apo 7%.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).



Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për opinion të kualifikuar me theksim të çështjes. Ministri duhet të siguroj se me rastin e përgatitjes së PVF do të prezantohet burimi i fondit nga granti i përgjithshëm i qeverisë si dhe të hyrat e buxhetuar nga donatorët të prezantohen me vlera të sakta.	Në PFV e 2018, është prezantuar granti i përgjithshëm i qeverisë si dhe të hyrat e buxhetuar nga donatorët të prezantohen me vlera të sakta.	Rekomandimi i zbatuar
2		Ministri duhet të siguroj se avancat e paarsyetuara do të prezantohen drejt dhe saktë në PFV si dhe të ndërmerr hapa të menjëhershëm për të siguruar të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe mbylljen e tyre (arsyeshmërinë e tyre) ashtu siç kërkohet me rregullat përkatëse.	Avnacet e paarsyetuara janë prezantuar drejtë. Ministri ka proceduar këtë çështje tek organet kompetente.	Rekomandimi pjesërisht i zbatuar
3		Ministri duhet të siguroj se huamarrja nuk do të prezantohet si buxhet i planifikuar për inkasim në PFV e MSh.	Huamarrja nuk është prezantuar si buxhet i planifikuar për inkasim në PFV e MSh.	Rekomandimi i zbatuar
4		Ministri duhet të siguroj se do të bëjë regjistrimin e të gjitha pasurive mbi 1,000€ në regjistra e pasurive si dhe për pasurit nën 1,000€ të bëjë zhvlerësimin.	Edhe pse janë marrë masa ende disa pasuri nuk kanë mundur të regjistrohen dhe regjistri është i pa plotë.	Rekomandimi pazbatuar
5		Ministri, po ashtu duhet të siguroj se detyrimet kontingjente dhe llogarit e arkëtueshme identifikohen saktë dhe të prezantohen si të tilla në PFV.	Pjesa e detyrimeve kontingjente është adresuar, ndërsa ende nuk është adresuar problemet me llogaritë e arkëtueshme.	Rekomandimi pjesërisht i zbatuar

6	Procesi i buxhetit	Ministri të siguroj se me rastin e planifikimit të buxhetit të analizohen nevojat dhe kërkesat reale dhe të bëjë monitorimin e vazhdueshëm të ekzekutimit të buxhetit dhe aty ku vërehen ngeçjet në realizim të ndërmerr masat adekuate për të përmirësuar performancën buxhetore.	Janë marrë masa në këtë drejtim mirëpo ende nuk ka arritur të adresohet ky rekomandim.	Rekomandimi pazbatuar
7	Të hyrat	Ministri duhet të bëjë shtimin e kontroleve në lidhje me harmonizimin mes kërkesës dhe shtypjes së banderolave në mënyrë që sasinë e shtypura të jetë në përputhje me sasinë e kërkuar për të minimizuar kostot shtesë të Agjencionit.	Janë marrë masa efektive për shtypjen e banderolave sipas kërkesës.	Rekomandimi i zbatuar
8	Të hyrat	Ministri duhet të siguroj se shqyrtimi i aplikacioneve për licencë importi për produkte dhe pajisje mjekësore të bëhet në pajtim me kriteret e përcaktuara ligjore.	Janë marrë masa efektive dhe aplikacionet shqyrtohen sipas kriterëve ligjore.	Rekomandimi i zbatuar
9	Pagat dhe shtesat	Ministri të sigurojë kontrole adekuate për të siguruar që bëhet verifikimi i pagesave para dhe pas procesimit të pagesave si dhe për vlerën e paguar më shumë të bëhet kthimi i mjeteve.	Janë masa adekuate për verifikim e listave para procesimit të pagesave. Pagesa e evidentuar në raportin tonë 2017 ishte bërë ndalesa	Rekomandimi zbatuar
10	Pagat dhe shtesat	Ministri duhet të marrë masa të menjëhershëm që për pozitat të cilat mbulohen me ushtrues detyre të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme me pozita të rregullta në pajtim me kërkesat ligjore.	Nuk janë marrë masa adekuate	Rekomandimi i pazbatuar
11	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të shtoj kontrole për të siguruar se për të gjitha pagesat e bëra do të bëhet konfirmimi i pranimit të barnave.	Janë marrë masa efektive, të gjitha pagesat janë me flet dërgesa.	Rekomandimi i zbatuar
12	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të siguroj se kontratat kornizë do të përcillen gjatë implementimit nga menaxherët e projekteve, dhe të siguroj se certifikimi i pagesave	Janë marrë masa efektive, janë caktuar menaxherët e kontratave dhe është krijuar softuer intern për menaxhimin e tyre.	Rekomandimi i zbatuar

		nuk do të bëhet mbi tavanin e përcaktuar për kontratat kornizë.		
13	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të siguroj se zyra e prokurimit nuk do kontraktoj barna të njëjtë me çmime të ndryshme për periudhën e njëjtë kohore. Për më tepër, ministri duhet të inicioj rishikimin e rasteve të përmendura më lartë për të parandaluar dëmtimin potencial të buxhetit.	Janë marrë masa efektive dhe nuk MSh nuk ka më kontrata për të njëjtat furnizime me operator të ndryshëm e çmime të ndryshme.	Rekomandi m i zbatuar
14	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të shtoj kontrole rreth menaxhimit të SMSF-së për të siguruar se të gjitha furnizimet (qarkullimi) e bëra për barna do të regjistrohen dhe evidentohen në sistem.	MSh është duke zhvilluar Sistemin e Informimit Shëndetësor dhe në të integrohet edhe moduli i SMSF.	Rekomandi m i pazbatuar
15	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të sigurojë se barazimet aktuale me ofruesit e shërbimeve të finalizohen për të pasur një pasqyrë sa më të qartë të pozicionit të MSh karshi ofruesve të shërbimeve. Aty ku mbeten mjete të lira të kthehen në buxhetin e ministrisë.	Janë marrë masa mirëpo ende nuk ka barazime.	Rekomandi m i pazbatuar
16	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të sigurojë mekanizëm adekuat i cili siguron respektim të plotë të obligimeve të pacientëve ndaj vendimeve të ministrisë, si një masë adekuate e arsytimit të shpenzimeve të krijuara. Më tutje, shuma e paguar mbi vlerën e lejuar të kërkohet të kthehet në buxhetin e ministrisë.	Ende nuk janë marrë masa adekuate.	Rekomandi m i pazbatuar
17	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të sigurojë mekanizëm për implementimin e plotë të marrëveshjeve të arritura për subvencionimin e OJQ-ve. Në rast të mos raportimit të plotë nga OJQ-të, në të ardhmen të rishikohen masat e ndëshkimit apo edhe të ndalimit të subvencionimit të tyre.	Janë marrë masa efektive. Asnjë OJQ e cila nuk ka raportuar sipas udhëzimeve adekuate nuk ka përfituar subvencione.	Rekomandi m i zbatuar
18	Investimet kapitale	Ministri të siguroj që janë vendosur kontrole adekuate të cilat konfirmojnë saktësinë dhe rregullsinë e implementimit të projekteve në mënyrë që çdo	MSh ka marrë masa adekuate, për çdo devijim nga kontrata ka aplikuar ndalesat e nevojshme.	Rekomandi m i zbatuar

		projekt të implementohet sipas kushteve të kontratës.		
19	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj mbikëqyrje adekuate gjatë realizimit të projekteve, në mënyrë që pagesat të kryhen në përputhje me situacionet përkatëse. Në rastin e tillë të kërkohet që këto mjete të zbriten në pagesat e mëtutjeshme.	Ministri ka caktuar komision për verifikim të pagesës së dyfishtë dhe është aplikuar ndalesa e saj.	Rekomandimi i zbatuar
20	Investimet kapitale	Ministri duhet që të adresoj këtë çështje me prioritet të lartë, në mënyrë që ky projekt të implementohet sa më shpejtë për të minimizuar rreziqet nga humbjet e mundshme financiare. Dhe se, në një kohë sa më të shpejtë të ju ofrohet mundësia e trajtimit të pacienteve me këtë aparat.	Ministri ka marrë në konsideratë rekomandimin dhe ka funksionalizuar pajisjen.	Rekomandimi i zbatuar
21	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj kontrole në përpilimin e specifikacioneve teknike, si dhe të sigurohet se është kryer një rishikim i tyre nga departamenti i prokurimit para inicimit të procedurave.	Ministri ka vendosur kontrole të shtuara në këtë segment dhe ka adresuar këtë çështje.	Rekomandimi i zbatuar
22	Obligimet	Ministri të siguroj se bordi ekzekutiv i TMJISHP të ketë kujdes me rastin e aprovimit të kërkesave për trajtim të pacientëve, duke pasur në konsideratë mundësitë buxhetore të ministrisë. Po ashtu duhet t'i jap prioritet shlyerjes së obligimeve për shkak se ministria mund të paditet nga operatorët ekonomik me që rast kostot do të rriten edhe më shumë.	Ministri ende nuk ka marrë masa për këtë çështje.	Rekomandimi i pazbatuar
23	Obligimet	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.	Ministri ende nuk ka marrë masa mjaft efektive për këtë çështje.	Rekomandimi i pazbatuar i mbyllur
24	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Ministri të siguroj që është zbatuar plani adekuat dhe konsekuent i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës	Ministri ka vendosur kontrole të shtuara për të adresuar rekomandimet në vazhdimësi. Ka krijuar një ekip i cili është duke përcjellë vazhdimisht	Rekomandimi i pazbatuar i mbyllur

		të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.	progresin e zbatimit të rekomandimeve.	
25	Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri të sigurojë se NjAB është e fokusuar në auditimin e fushave kyçe në mënyrë që menaxhmentit t'i ofrojë siguri të mjaftueshme. Po ashtu një bashkëpunim më i ngushtë dhe një komunikim më efektiv në mes kësaj njësie dhe menaxhmentit do të ndikoj në parandalimin/eliminimin e dobësive të shumta që po e përcjellin këtë ministri. Më tutje, ministri të siguroj funksionimin e plotë të komitetit të auditimit.	Ministri ka marrë masa adekuate në këtë drejtim. NjAB ka qenë e fokusuar në auditimin e fushave kyçe përgjatë 2018.	Rekomandim i zbatuar
26	Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet të siguroj se me rastin e transferimit të nëpunësve civil të ketë parasysh ekuivalencën e gradës dhe hapit të pagës.	Ministri ka marrë masa adekuate në këtë drejtim. Ishte anuluar transferi i bërë me vendim	Rekomandim i zbatuar
27	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Ministri të siguroj një raportim menaxherial dhe një mbikëqyrje efektive për të siguruar shtimin e vlerës për para. Për tu arritur kjo, ministri duhet të siguroj përfshirjen e të gjitha akterëve kyç në kuadër të ministrisë.	Ministri ka marrë masa për përmirësimin e proceseve të raportimit dhe llogaridhënies, në shumë fusha ka përmirësim. Përkundër kësaj ende janë prezentë disa dobësi.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
<b>Nr.</b>	<b>Fusha e auditimit</b>	<b>Rekomandimet e vitit 2018</b>		
A1	PFV	Ministri duhet të siguroj se do të bëhet regjistrimi i të gjitha pasurive kapitale dhe jo kapitale si dhe raportimin e të gjitha llogarive të arkëtueshme.		
B1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të përcaktoj një dinamikë më të përshtatshme të aktiviteteve, të përmirësoj kontrollin në fushën e kontraktimeve, mbikëqyrjes dhe realizimit të projekteve për tu siguruar se ato realizohen sipas planit të parashikuar.		
A2	Paga dhe mëditje	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve duke bërë monitorimin e vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Nëse problemi nuk mund të zgjidhet brenda ministrisë, kjo duhet të diskutohet në nivel të Qeverisë dhe të nxirren vendimet e duhura.		
A3	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të siguroj se Drejtori Ekzekutiv i QKTGJ-së zbaton me konsistencë kërkesat e rregulloreve dhe formon me kohë komisionet për pranimin e mallrave dhe pasurive të blera jo financiare.		

A4	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të siguroj se Drejtori Ekzekutiv i QKTGJ-së do të përmbushë kërkesën ligjore që të gjithë menaxherët e kontratave pas përfundimit të kontratave të përgatisin raporte të hollësishme konform rregulloreve të prokurimit.
B2	Subvencion e dhe transfere	Ministri duhet menjëherë të krijojë një komision për të zbatuar një proces harmonizimit që do të mbulojë, të gjitha spitalet private dhe se çdo fond që u paguhet këtyre spitaleve dhe që tejkalojnë shpenzimet aktuale të trajtimit duhet të kthehet në MSh.
B3	Subvencion e dhe transfere	Ministri duhet të krijojë mekanizma efektiv për të siguruar se palët përfituese janë duke e respektuar obligimet për arsyeshmërinë e plotë të shpenzimeve të subvencionuara nga ministria.
A5	Obligimet	Ministri duhet të siguroj se njësitë e MSh-së faturat i evidentojnë dhe pranojnë përmes protokollit dhe se të njëjta regjistrohen dhe procedohen me kohë për pagesë.
B4	Obligimet	Ministri të siguroj se Bordi ekzekutiv i TMJISHP me rastin e aprovimit të kërkesave për trajtim të pacientëve, duhet të merr në konsiderim fondet buxhetore në dispozicion dhe të mos aprovoj kërkesa që krijojnë obligime për vitet vijuese.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

---

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.



## Shtojca II: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
7 05 2019			
Org. Qendrore Org. Qendrore Org. Qendrore	Skut. Kodit Klasifik. Kodit Klasifik. Kodit	Nr. Prot. Dr. Prot. Prot. No.	Nr. Eftimesh Nr. Eftimesh No. Pages
03	47	682	1



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË / MINISTARSTVO ZDRAVSTVA / MINISTRY OF HEALTH	
Agjencia Org. Org. Juridicka Org. Unit	02
Nr. Prot. Dr. Prot. Prot. No.	05-2193
Nr. Eftimesh No. Pages	-1-
Data: Date: 06 / 05 / 2019	
Pristine / a	

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E SHËNDETËSISË / MINISTARSTVO ZDRAVSTVA / MINISTRY OF HEALTH  
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Ured Generalnog Sekretara / Office of the Secretary General

## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Dr. Naim Bardiqi

Sekretar i Përgjithshëm  
Ministria e Shëndetësisë

